



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
KOMISIONI I KONKURENCES

---

**V E N D I M**

nr.436, datë 27.09.2016

**“Për një ndryshim në Vendimin nr. 428, datë 27.07.2016 “Për përjashtimin individual nga ndalimi të Marrëveshjes -Tip “DIGITALB - OPERATOR TELEVIZIV”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
Servete	GRUDA	Zv/Kryetare
Koço	BROKA	Anëtar
Iva	ZAJMI	Anëtare
Eduart	YPI	Anëtar

Në mbledhjet e tij të datës 27.09.2016 shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Sqarimin e Vendimit nr. 428, datë 27.07.2016 “Për përjashtimin individual nga ndalimi të Marrëveshjes - Tip “DIGITALB - OPERATOR TELEVIZIV”

**Baza ligjore:** Nenet 5, 24 shkronja d, 49 dhe 50 (pika 1) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Kodi i Procedurës Administrative, neni 120.

**Komisioni i Konkurrencës** pas informacionit ardhur nga operatorët e tregut objekt i marrëveshjes, lidhur me disa paqartësi në dispozitivin e Vendimit nr. 428, datë 27.07.2016 “Për përjashtimin individual nga ndalimi të Marrëveshjes -Tip “DIGITALB - OPERATOR TELEVIZIV”.

**VËREN SE :**

Me Vendimin nr. 428, datë 27.07.2016, Komisioni i Konkurrencës është shprehur në lidhje me përjashtimin individual nga ndalimi i Marrëveshjes - Tip “DIGITALB - OPERATOR TELEVIZIV” se:

1. Marrëveshja tip mes Digitalb dhe operatorëve televizivë përjashtohet nga ndalimi

për të gjithë operatorët që kanë shprehur vullnetin e tyre për të nënshkruar marrëveshjen në respektim të kushteve dhe detyrimeve të mëposhtme:

- a) **Në nenin 5 të hiqet pika 2** “X TV është i detyruar që të mos ofrojë për transmetim kanalën ndaj asnjë platforme/operator tjetër satelitor, tokësor, dixhital, kabllor, apo çdo formë tjetër transmetimi, me apo pa pagesë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ....”;
- b) **Në nenin 5 të hiqet pika 4** : “X TV nuk mund të transmetojë në faqen e saj WEB në kohë reale apo në transmetim direkt” dhe pikat në vijim, pikat 4.1 dhe 4.2.

Në pjesën arsyetuese të Vendimit nr. 428, datë 27.07.2016 (pika VI “Kushtet për përjashtim”), Komisioni i Konkurrencës ka bërë prezent ekzistencën e parashikimeve të mëposhtme në marrëveshjen e shqyrtuar:

**Në nenin 5, pika 6 përcaktohet se:** “X TV Channel, me lidhjen e kësaj kontrate do t’i bëjë me dije çdo autoriteti shtetëror, publik dhe privat se të drejtat e transmetimit të kanalit i takojnë vetëm Digitalb dhe asnjë operatori tjetër televiziv. Në rastet e transmetimit të paligjshëm të kanalit, X TV me kërkesën e Digitalb, do të jenë pjesë e mbrojtjes së të drejtave të transmetimit të kanalit në të gjithë format që parashikon legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të drejtave nga mbajtësi i ligjshëm i tyre”.

**Në nenin 6 “Të Drejtat dhe Detyrimet e DGA” vihet re se:**

Sipas pikës 2 “Digitalb përfiton të drejtën ekskluzive të transmetimit dhe distribucionit televiziv të kanalit X TV në të gjitha format e njohura të transmetimit (satelitor, tokësor, kabllor, internet, Pay Tv, Free Tv, PPV, IPTV, mobile tv, OTT, shërbim on line, ofruar shërbimi përfshirë aksesin e kushtëzuar etj, sipas legjislacionit në fuqi për mediat audiovizive). Digitalb me anë të kësaj kontrate është zotëruar i vetëm i të drejtave për distribucionin e kanalit për ritransmetimin e njëkohshëm apo të vonuar në çdo mënyrë transmetimi, përveç atij analog të cilin e zotëron vetë X TV në zonën e përcaktuar, sipas licensimit të tij nga organi kompetent AMA”.

Që të respektohet vendimmarrja e Autoritetit të Konkurrencës nr.428, datë 27.07.2016, pra të hiqet nga përmbajtja e Marrëveshjes së përjashtur nga ndalimi detyrimi i “X TV” për të mos ofruar për transmetim kanalën ndaj asnjë platforme/operator tjetër satelitor, tokësor, dixhital, kabllor, apo çdo formë tjetër transmetimi, me apo pa pagesë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë....” , atëherë automatikisht duhet të hiqen nga përmbajtja e kësaj Marrëveshje edhe dispozitat e mësipërme, të cilat janë riformulim dhe vijim logjik i Nenit 5 pika 2 dhe pika 4, 4.1 dhe 4.2 , për të cilat Komisioni i Konkurrencës është shprehur se duhet të hiqen.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 24, shkronja d, nenet 5, 49 dhe 50 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), dhe nenit 120 të Kodit të Procedurës Administrative, Komisioni i Konkurrencës:

## VENDOSI:

1. Në dispozitivin e Vendimit nr 428, datë 27.07.2016 “Për përjashtimin individual nga ndalimi të Marrëveshjes - Tip “DIGITALB - OPERATOR TELEVIZIV”, të shtohen kushtet dhe detyrimet:

a) **Në nenin 5 “Detyrimet e X TV”, të hiqet pika 6:** “X TV Channel, me lidhjen e kësaj kontrate do t’i bëjë me dije çdo autoriteti shtetëror, publik dhe privat se të drejtat e transmetimit të kanalit i takojnë vetëm Digitalb dhe asnjë operatori tjetër televiziv. Në rastet e transmetimit të paligjshëm të kanalit, X TV me kërkesën e Digitalb, do të jenë pjesë e mbrojtjes së të drejtave të transmetimit të kanalit në të gjithë format që parashikon legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të drejtave nga mbajtësi i ligjshëm i tyre”.

b) **Në nenin 6 “Detyrimet e Digit-alb”, të hiqet pika 2:** “Digitalb përfiton të drejtën ekskluzive të transmetimit dhe distribucionit televiziv të kanalit në të gjitha format e njohura të transmetimit (satelitor, tokësor, kabllor, internet, Pay Tv, Free Tv, PPV, IPTV, mobile etj) Digitalb me anë të kësaj kontrate është zotëruesi i vetëm i të drejtave për distribucionin e kanalit për ritransmetimin e njëkohshëm apo të vonuar në çdo mënyrë transmetimi, (përveç atij analog të cilin e zotëron vetë X TV në zonën e përcaktuar sipas licensimit të tij nga organi kompetent, AMA)”.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete Gruda  
(\_\_\_\_\_)

Zv.Kryetare

Koço Broka  
(\_\_\_\_\_)

Anëtar

Iva Zajmi  
(\_\_\_\_\_)

Anëtare

Eduard YPI  
(\_\_\_\_\_)

Anëtar

Lindita MILO (LATI)

\_\_\_\_\_  
KRYETARE